

Caritas Kosova

Raporti
Vjetor
2014



PËRMBAJTJE:

FJALA HYRËS

3

PROGRAMI I PËRKUJDESIT SHTËPIAK

4

PROGRAMI KUNDËR TRAFIKIMIT TË
QENIEVE NJERËZORE

5

PROGRAMI NACIONAL I PAQËS DHE PAJTIMIT

6

PROGRAMI PËR PERSONAT ME NEVOJA TË VEQANTA

10

PROGRAMI I INTEGRIMIT TË KOMUNITETEVE - RAE

11

PROGRAMI I AGRIKULTURËS

13

RE-INTEGRIMI I TË BURGOSURVE PAS LIRIMIT

14

PROGRAMI EDUKATIV

15

PROGRAMI I ASISTENCËS SOCIALE

15

PROJEKTI I EMERGJENCAVE

16

BUXHETI 2014

17

Të dashur miq dhe mbështetës të Caritas Kosovës!



Caritas Kosova, ka vazhduar rrugëtimin e saj në bamirësi duke mos u ndalur asnjëherë, mirëpo ndër vite rrethanat kanë ndryshuar. Kosova aktualisht nuk është më në situatë emergjence dhe vëmendja e botës së fuqishme, është e drejtuar në vendet me varfëri të skajshme apo në rajone konflikti, si dhe në vendet e prekura nga katastrofat natyrore.

Për kundër këtij fakti, Caritas Kosova fuqishëm trajton plagët e kësaj shoqërie me një përkushtim serioz dhe profesional duke shënuar progres të madh në zhvillim e saj si institucion i besueshëm në vend. Sot, Caritas Kosova është një model i suksesshëm në Evropën Juglindore për profesionalizmin e dëshmuar në menaxhimin dhe implementimin e projekteve. Shumë donatorë dhe partnerë të Familjes Caritas, kanë mbështetur angazhimin tonë përmes projekteve të përbashkëta. Përveç kësaj edhe Komisioni Evropian me prezencë në Kosovë ka financuar implementimin e programeve madhore të Caritas Kosovës, të cilat me profesionalizëm të shkallës së lartë i përmbushen të gjitha kriteret dhe standardet evropiane.

Prioritetet strategjike të Caritas Kosova janë promovimi i paqes dhe i vlerave universale që i japin kuptim jetës njerëzore duke ju shërbyer më të varfërve dhe të pambrojturve. Pjesë e përpjekjeve tona është mbrojtja e dinjitetit të njeriut. Aktualisht në Kosovë mbi 45% të popullsisë konsiderohen të varfër, ndërsa në varfëri të skajshme jetojnë mbi 15% prej tyre. Ne si Caritas nacional në Republikën e Kosovës, gjithnjë mobilizojmë të gjitha mundësitë në mbështetje të njeriut në nevojë, sepse madhështia e njeriut dhe të drejtat e tij janë ta pacenueshme, meqë këto Hyji ia ka dhuruar dhe garantuar çdo individ. Bazuar në këto parime, janë ndërtuar dokumente kishtarë, përsiatjet e shumë humanistëve të shquar, madje përbejnë edhe themelin e qeverive demokratike sa i përket mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut. Disa nga këto Dokumentet zyrtare të Kishës që trajtojnë çështjet e dinjitetit të njeriut janë: Enciklika “Pacem in terris” (Paqja në tokë) e Gjonit XXIII, Kushtetuta e Koncilit të Vatikanit “Gaudium et Spes” (Gëzimi dhe shpresa), Deklarata “Dignitates Humane” (Dinjteti i personit), dhe Katekizmi i Kishës Katolike i cili i kushton shumë vëmendje dinjitetit të njeriut. Po ashtu, veçojmë letrën e Benediktit XVI (2009) “Caritas in Veritate”, e cila fuqishëm mbështet veprimtarinë karitative, duke porositur qartë dhe gjerësisht që politikat e Caritasit duhen të jenë në mbështetje të personit, pa dallim. I njëjti në Enciklikën “Deus Caritas Est” (Hyji është Dashuri) thekson përgjegjësitë e Kishës në të gjitha nivelet në respektimin e dinjitetit njerëzor, ku veçmas na fton ta shprehim ngrohtësinë më humane në raport me njeriun, duke plotësuar kështu vullnetin e Hyjit. Ndërsa filozofi Romano Guardini, shkruan se njeriu nuk guxon të manipulohet nga askush, të keqpërdoret e nënçmohet, dhe as të cenohet në të drejtat elementare. Vërtetë, njeriu në kohën bashkëkohore, posaçërisht në hapësirat tona, në mënyrë permanente i ekspozohet këtyre presioneve. Prandaj, Caritas Kosova anekënd Kosovës synon të jetë pranë njeriut më në nevojë dhe atyre të marginalizuar duke ua rikthyer dinjitetin.

Përveç promovimit të paqes dhe pajtimit ndëretnik, lufta kundër trafikimit me qenie njerëzore mbetet prioritet për Caritasin, ku synojmë mbrojtjen dhe ri-integrimin e viktimave (potenciale) të këtij fenomeni. Ndërsa përmes programit "Përkujdesi Shtëpiak" jemi afër njerëzve të prangosur brenda mureve të tyre dhe krejtësisht të harruar, duke shëruar jo vetëm plagët e tyre fizike por duke

trajtuar edhe dhembjen e plagëve të tyre shpirtërore, ku Caritasi është bërë fener që ndriçon vetminë e tyre të errët. Gjithashtu, puna jonë edukative dhe arsimore nëpërmes qendrave tona socio-edukative, në Dubravë të Ferizajt dhe Ali Ibër të Gjakovës, me gjeneratat e reja e sidomos nga komunitetet minoritare, si p.sh. Komunitetet Rom, Ashkalinj dhe Egjiptian, janë vlerësuar nga Komisioni Evropian në tërë rajonin si shembulli më i mirë. Zhvillimi i sektorit të agrikulturës apo asistencë ndaj fermerëve është një përkrahje e fuqishme që mundëson mbijetesën dhe zhvillimin në zonat rurale. Një grup në marginat e shoqërisë sonë janë pikërisht gratë e burgosura në Qendrën Korrektuese të Lipjanit, të cilat aftësohen profesionalisht për t'ju rikthyer serish jetës normale pas lirimt. Pa dyshim Caritasi vazhdon të jetë zëri i njerëzve me nevoja të veçanta përmes projekteve të ndryshme.

Shkrimtari gjerman Erich Kästner në një rast kishte thënë: “Edhe me gurët që hidhen në rrugën e jetës mund të ndërtohet diçka e bukur”. Pra, përkundër sfidave me të cilat mund të përballemi në misionin tonë, dëshiroj të falënderoj bashkëpunëtorët e Zyrës Qendrore, Zyrrave Rajonale dhe të Projekteve për unitetin e treguar në realizimin e objektivave që ka Caritasi i Kosovës: që të jemi afër njeriut në nevojë dhe të ndajmë me të dhembjen, sepse ajo zvogëlohet kur e ndajmë me të tjerët dhe jemi të bashkuar. Ndërsa gëzimi që e ndajmë me të tjerët rritet dhe bëhet më madhështor. Kështu që, Caritas Kosova do të vazhdojë të mbledh gurët e jetës për të ndërtuar diçka të bukur për njerëzit në nevojë. Në fund dhe veçanërisht, falënderoj të gjithë partnerët dhe njerëzit e vullnetit të mirë për bashkëpunimin, mbështetjen dhe besimin!

Zoti Ju Bekoftë!

Don Viktor SOPI
Drejtor Gjeneral



Ju kam si fëmijë!

Caritas Kosova (CK) përmes implementimit të programit "Përkujdesi Shtëpiak" që nga viti 2009 mbështet personat e moshuar në nevojë, të sëmurët kronikë dhe personat me nevoja të veçanta. Shërbimet tona shëndetësore dhe njëkohësisht edhe sociale ofrohen për personat e sëmurë, të vetmuar, personat me sëmundje me regjim shtrati (të pa lëvizshëm), personat me sëmundje të ndryshme psikike si dhe personat me aftësi të veçanta. Përveç përfutueseve direkt, ne i përkrahim edhe familjarët e tyre të cilët sipas nevojës aftësohen për

përkujdesjen adekuate ndaj anëtarit të sëmurë. Rezultatet e arritura dhe rëndësia e ofrimit të këtyre shërbimeve direkt në shtëpi, si dhe rritja e kërkesës për këto shërbime ka ndërgjegjësuar edhe institucionet vendore, të cilat në nivel lokal dhe qendror kanë konfirmuar suksesin e programit. Fillimisht ky program është financuar dhe mbështetur kryesisht nga Caritasi Gjerman. Kjo mbështetje kishte ardhur si rezultat i kërkesave të vazhdueshme që kishte paraqitur CK në favor të personave të moshuar dhe të sëmurë në Kosovë, të cilët jetojnë me sëmundje me regjim shtrati. Qysh nga dita e parë kemi mobilizuar një staf profesional të pajisur me mjetet më të reja shëndetësore, e që ishin të trajnuar sipas standardeve gjermane profesionale për implementim të këtij programi me përkrahjen e Caritasit Gjerman. Në vazhdimësinë e





implementimit të programit, CK me eksperiencën dhe si akter pionier me tutje ngriti kapacitetet profesionale, thelloj kontaktet dhe bashkëpunimin me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale si partnerë strategjikë në implementim e këtij programi.

Konkretisht gjatë vitit 2014, përmes bashkëpunimit me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Komunave të Ferizajt, Suharekës, Mitrovicës, Rahovecit, Klinës, Vitisë, Shtimës, Drenasit dhe Malishevës, programi Home Care është implementuar në 12 qendra në nivel të Kosovës, ku ishin të angazhuara mbi 22 ekipe mobile të kujdesit shtëpiak dhe mbi 44 infermiere dhe staf mjekësor për t'u shërbyer personave të sëmurë. Ekipet tona mobile kanë realizuar gjithsej 32.434 vizita shtëpiake për të sëmurit dhe të



vetmuarit. Në përkujdesjën tonë të vazhdueshme ishin mbi 1228 persona në nevojë. Mision jonë është ofrimi i një jetë të dinjitetshme dhe prandaj kemi qenë pranë personave të sëmurë dhe të moshuar deri në çastin e fundit të jetës së tyre duke ju lehtësuar sëmundjet, ku konkretisht 187 persona u shuan paqësisht nga jeta vitin e kaluar. Sidomos familjaret e mërguar janë mirënjohës që Caritas Kosoves u qëndron afër prindërve të tyre në çdo kohë. Implementimi i programit Home Care gjatë këtij viti është cilësuar edhe si një promotor i rëndësishëm i paqes dhe pajtimin ndërmjet komuniteteve, meqë shërbimet ofrohen për te gjithë qytetaret në Kosovë, pa dallim.

Me qëllim që të sëmurëve me regjim shtrati dhe familjarëve të tyre t'ju krijohen kushte më të mira për trajtim mjekësor në shtëpi, janë shpërndarë mbi 143 shtretër spitalor, 245 karroca invalidore për nevoja të moshuarve dhe atyre që janë të palëvizshëm, duke përfshirë edhe dhjetëra dyshek anti-dekubitar, si dhe shumë pajisje tjera shëndetësore.


Përveç ofrimit të shërbimeve profesionale shëndetësore, angazhimi i Caritas Kosovës synon edhe përfshirjen sociale të personave të sëmurë duke u kujdesur jo vetëm për plagët fizike të të moshuarve, por edhe përkrahjen e tyre shpirtërore. Një e moshuar e vetmuar në Klinë tha: *"...e vetmuar që jam kur ju shoh juve, është njëjtë sikur të shihja fëmijët e mi. Jeta ime pa ju nuk do të kishte kuptim. Faleminderit që po më vizitoni çdo ditë."* Pikërisht këto emocione na japim me tutje motivim për t'u angazhuar në implementimin e këtij programi. Për fund, krahas vizitave në terren, nëpërmjet këtij programi kemi arritur funksionalizimin e shumë qendrave të reja shëndetësore në nivel vendi duke ju ofruar qasje më të lehtë në qendrat më të afërta shëndetësore për të gjithë njerëzit.

Fëmijë, keni kujdes!



Lufta kundër trafikimit me qenieve njerëzore, ka vazhduar të jetë një ndër prioritetet kryesore të veprimtarisë së Caritas Kosova për vitin 2014. Programi ynë kundër këtij fenomeni mbështetet nga Secours Catholique Caritas France, me anë të cilit promovohet parandalimi i trafikimit të qenieve njerëzore përmes fushatave ndërgjegjëse, fuqizohen viktimat (potenciale) përmes riintegritit socio-ekonomik të tyre në shoqëri, si dhe duke avancuar dhe rritur kapacitetet e strehimoreve. Gjatë vitit 2014, Caritas Kosova ka qenë rregullisht në koordinim me strehimoret e Kosovës dhe gjatë kësaj periudhe janë nënshkruar marrëveshje konkrete me Strehimoren e Viktimave në

Prishtinë, Gjiilan dhe Mitrovicë në mënyrë që të ngritën kapacitetet e tyre dhe të mbështetet riintegrimi i viktimave të strehuara. Nën kornizën e këtyre marrëveshjeve, nëntë viktima janë punësuar në mënyrë të suksesshme në tregun kosovar të punës. Veçanërisht në regionin e Ferizajt, Caritas Kosova në bashkëpunim me Komunën e Ferizajt ka promovuar dhe mbështetur në mënyrë aktive hapjen e Strehimores së Viktimave në Ferizaj. Krahas



kësaj arritjeje, Caritas Kosova po ashtu ka ngritur ndërgjegjësimin e fëmijëve të komunitetit Ashkali në lidhje me të drejtat e tyre duke festuar Ditën Ndërkombëtare kundër Punës së Fëmijëve me 12 Qershor. Përveç kësaj, më 9 Tetor kemi organizuar Konferencën Kombëtare Kundër Abuzimit dhe Trafikimit të Fëmijëve në Kosovë, në kuadër të muajit kundër trafikimit të deklaruar nga Qeveria e Kosovës. Personalitete të shquara dhe ekspertë e fushës së trafikimit iu drejtuan pjesëmarrësve, në mesin e të cilëve përmendim: Sasa Rasic – Zëvendësministër në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Koordinator Kombëtar kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore; Ramadan Ahmeti – Kapiten i Policisë së Kosovës; Don Viktor Sopi – Drejtor Gjeneral i Caritas Kosova si dhe Znj. Jacqueline de Bourgoing – Drejtoreshë për Europë dhe Azi nga Caritasi Francez. Mbi 130 persona morën pjesë në konferencë, përfshirë përfaqësues nga koalicioni i strehimoreve dhe partnerët kryesorë të Caritas Kosova. Konferenca pati jehonë të madhe, duke tërhequr vëmendjen e mediave lokale e kombëtare. Krahas intervenimit tonë të vazhdueshëm, gjatë vitit 2014 kemi filluar një pilot projekt të ri në bashkëpunim me Catholic Relief Services (CRS) dhe Caritasin Zviceran. Projekti synon të parandalojë punën e detyruar, lëmshën dhe abuzimin e të miturve në regionin e Ferizajit dhe të Prizrenit. Në këtë kontekst, ne bashkëpunojmë ngushtë me grupet punues (Task Force) përkatëse për të luftuar kundër trafikimit të fëmijëve në mënyrë që të rrisim nivelin e identifikimit dhe referimit të rasteve. Po ashtu jemi në partneritet me shkollat fillore në Ferizaj dhe Prizren, ku një ekspert i jashtëm trajnimi është angazhuar që të ofrojë trajnime për mësime dhe psikologët e shkollave për të identifikuar fëmijët e abuzuar. Përveç kësaj, janë përfshirë edhe një numër i bizneseve dhe së bashku me ne, po parandalojmë që në këto lokale të shiten produktet nga fëmijëve që detyrohen të punë. Së fundi, një numër i fushatave ndërgjegjëse kanë vazhduar të organizohen përgjatë tërë vitit.

Të gjithë jemi Kosovë!

KOMPONENTI I: MITROVICA

Caritas-i në Kosovë është duke implementuar "Programin mbi Paqen dhe Pajtimin" në qytetin e ndarë të Mitrovicës me mbështetje të Secourse Catholique -Caritas France që nga viti 1999. Veprimtaria jonë në radhë të parë fokusohet në integrimin social të komuniteteve të ndryshme etnike përmes animacioneve sociale, edukimit,



aktiviteteve dhe ngjarjeve të përbashkëta artistike, si dhe të ndërmjetësimit dhe aktiviteteve të lobimit. Po ashtu, promovojmë të drejtat e njeriut, duke ofruar trajnime të veçanta për gratë dhe fëmijët, aktivitete me animacione për të rinjtë dhe fëmijët, luftimin e trafikimit me qenie njerëzore, si dhe kemi zbatuar aktiviteteve vetëdijësuese mbi dhunën në familje. Përveç kësaj, konsiderojmë që aktivitetet tona në zhvillimin ekonomik janë një instrument i rëndësishëm për të gjeneruar të ardhura dhe për të promovuar



relacione të mira brenda komunitetit, ku dhe kemi ndërmjetësuar për punësim dhe janë ofruar trajnime për bizneset e vogla në zonat rurale. Të gjitha aktivitetet tona të paqes dhe pajtimit kanë për qëllim të forcimin e qëndrueshëm të shoqërisë multi-kulturore në Mitrovicë. Duke pasur parasysh se Kosova është një vend me një përqindje të lartë të popullsisë së re të papunë, Caritasi ka ofruar trajnime shtesë për të rinjtë në mënyrë që ata të zhvillojnë shkathtësitë e tyre dhe të përgatiten për tregun e punës. Ky angazhim i yni është përkrahur nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, përkatësisht Departamenti i Rinisë. Njëzet e dy (22) të rinj të rajonit të Mitrovicës (mosha: 15-24) morën pjesë në trajnim ku u aftësuan se si hartohet CV-ja, letra përkrahëse, dosja për aplikim pune, si dhe si zhvillohet intervista e punës. Po ashtu në fazën finale të rinjtë u trajnuan në temën e leadershipit. Për fund të gjithë pjesëmarrësit janë certifikuar për ndjekjen e suksesshme të trajnimit. Falë këtij cikli të trajnimeve disa prej të rinjve me sukses i kanë implementuar njohuritë e fituara dhe janë tashmë të punësuar. Me qëllim të promovimit të aktiviteteve rekreative të sportit, argëtimit dhe shkëmbimit midis të rinjve që jetojnë në Mitrovicë, Caritas Kosova organizoi një turne të futbollit në bashkëpunim me “Terre des Homes”. Gjegjësisht, ky turne grumbulloi dhjetë (10) ekipe multi-etnike të futbollit me nga njëmbëdhjete (11) anëtarë. Fillimisht u krijuan ekipet, u bë regjistrimi i tyre për garë dhe u kryen stërvitjet e rregullta. Madje, u ftuan në stërvitje edhe lojtarë të njohur të futbollit Mitrovicës për t’i udhëzuar lojtarët rreth taktikave në futboll, veçanërisht duke i inkurajuar dhe motivuar anëtarët e ekipeve pjesëmarrëse. Për fund, ndeshjet e futbollit janë luajtur çdo muaj në një periudhë një-vjeçare, të cilat u cilësuan si aktivitete atraktive sportive për të rinjtë duke kontribuar kështu në dialogun dhe bashkëjetesën ndër-etnike, ku dhe u formuan shume miqësi të reja ndër-kulturore. Ndër tjerash, nën ombrellën e Sektorit për Zhvillim të qëndrueshëm të Caritas Kosovës kemi mbështetur Unionin e Shoqatës së Fermerëve të Mitrovicës në organizimin e Panairit Regional Bujqësor "Mitrovica 2014" me 9-10 Tetor 2014 në Mitrovicë. Kjo ngjarje u organizua në partneritet me Caritasin Belg dhe Ambasadën Britanike, ku i pranishëm ishte edhe SH.T. Ambasadori Ian Cliff i shoqëruar nga Drejtori ynë Gjeneral Don Viktor Sopi. Nën ombrellën e sektorit të zhvillimit të qëndrueshëm të Caritas Kosova, mbështetur nga Ambasada e Britanisë së Madhe dhe Caritasi Ndërkombëtar Belg, për herë të dytë Caritas Kosova realizoi projekt me synim fuqizimin e fermerëve nga Leposavici dhe Mitrovica Jugore. Me anë të këtij projekti, rreth dyqind fermerë përfituan nga trajnimet dhe vizitat studimore të ofruara gjatë vitit 2014. Përveç trajnimeve dhe vizitave studimore, janë shpërndarë dhe pako bujqësore për përfituesitë e rajonit të Leposaviqit dhe Mitrovicës Jugore. Kësaj here 28 fermerë kanë përfituar pako në sektorin e bletarisë, frutave dhe kultivimit të perimeve, bujqësi, turizëm rural dhe ekoturizmin.



KOMPONENTI 2: PRISHTINA

Nën koordinimin e Zyrës sonë Rajonale në Prishtinë, mbështetur nga Caritas Franca, Caritasi i Zvicrës dhe Friedrich-Ebert Stiftung, Caritas Kosova ka realizuar komponentin e dytë të Programit për Promovimin e Paqes me qëllim të promovimit të vlerave të paqes dhe pajtimit (me fokus në komunitetin shqiptar dhe serb) në mënyrë që të forcohet multi-kulturaliteti i shoqërisë kosovare. Disa tryeza të rrumbullakëta u organizuan për të rinjtë dhe gratë nga komuna e Shtërpçës dhe Mitrovicës, ku është tematizuar paqja dhe pajtimi ndërmjet komuniteteve të ndryshme etnike, fetare dhe kulturore dhe janë identifikuar ngjashmëritë kulturore të njerëzve dhe grupeve etnike që jetojnë në vendet e Ballkanit Perëndimor. Veçanërisht këto ngjashmëri dhe përfshirja e tyre institucionale u theksuan nga pjesëmarrësit që duhet të shërbejnë si faktor për përmirësimin e bashkëjetesës. Pikërisht në këtë kontekst, Caritas ka ofruar kurse të gjuhës shqipe dhe serbe për të tejkaluar barrierat e komunikimit dhe për të nxitur dialogun ndëretnik në mes serbëve dhe shqiptarëve. Për tre muaj radhazi në kurs morën pjesë më shumë se 30 pjesëmarrës. Në vitin 2014 si ngjarje tradicionale të promovimit të paqes u organizua tryeza e rrumbullakët me temën *"Evaluimi i Procesit të Paqes dhe Pajtimit në Kosovë"*, ku panelistë ishin autoritete ndërkombëtare dhe vendore, si: SH.T. Ian Cliff - Ambasador i Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë; SH.T. Jan Braathu - Ambasadori i Republikës Norvegjeze në Kosovë; Z. Husnia Bećković - Zëvendës Ministër në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim; Znj. Besa Luzha - Zyra FES në Prishtinë; Z. Xhabir Hamiti - Profesor i Teologjisë; Znj. Jelena Krstić - Fondi për të Drejtën Humanitare në Beograd; dhe Z. Shpend Kursani - Analist. Panelistët theksuan se është shënuar progres i konsiderueshëm në procesin e paqes dhe pajtimit në Kosovë; megjithatë, kemi shumë punë për të bërë në këtë proces sfidues, ku organizatat ndërkombëtare kanë luajtur një rol vendimtar. Një tjetër moment historik në këtë proces do të jetë procesi i normalizimit të marrëdhënieve në mes Republikës së Kosovës dhe Serbisë, sidomos ballafaqimi me të kaluarën. Caritas Kosova do të vazhdojë të jetë promotor i fuqishme në ndërmjetësimin e procesit të paqes dhe pajtimit në mes grupeve etnike.

KOMPONENTI 3: PROGRAMI NACIONAL I ANIMACIONEVE



Që nga viti 1999 Caritas Kosova, në bashkëpunim të ngushtë me Secours Catholique Caritas Franca, ka organizuar në vazhdimësi aktivitete arsimore dhe animacione (dramë, vallëzim, këndim, kampe verore, karnavale dhe aktivitete sportive) me fëmijët, të rinjtë dhe vullnetarët e grupeve në Dioqezën e Kosovës, duke përfshirë edhe trajnime të ndryshme për trajnerët e animacioneve, dhe transferimin e njohurive specifike për organizimin dhe zbatimin e projekteve. Përmes punës sonë gjatë vitit 2014, kemi konsoliduar strukturën e vullnetareve të Caritas-it dhe janë përfshirë të gjithë vullnetarë pa dallim feje, përkatësie etnike, gjinie dhe moshe në veprimtarinë e Caritas Kosovës. Me ç'rast janë regjistruar mbi 317 vullnetarë në databazën tonë nacionale, me të cilët do të nënshkruhen edhe kontrata për shërbime vullnetare. Po ashtu është intensifikuar bashkëpunimi me dekanatet, përkatësisht famullitë, e Dioqezës së Kosovës përmes vizitave të rregullta në të gjitha famullitë duke zhvilluar një anketë, e cila do të pasqyroj informacionet e përmbledhura të jetës pastorale në çdo famulli. Ndër tjerash, kemi mbështetur kremtimin e karnavaleve që u organizuan nga vullnetarët e regjionit të Prizrenit e ku morën pjesë rreth 180 fëmijë, të rinjëve dhe grupeve tjera rinore. Po ashtu mbi 22 vullnetarë të rinj nga famullia Budisalc u trajnuan nga stafi i Caritas Kosova për të organizuar aktivitete animuese me fëmijë. Njohuritë e fituara gjatë këtij trajnimi ju kanë shërbyer jashtëzakonisht shumë këtyre vullnetarëve që me mbështetje financiare nga Caritas Kosova dhe donatorë të tjerë të realizojnë një kamp veror, në të cilin morën

pjesë 150 fëmijë nga kjo famulli. Ndërsa, vullnetarët e famullisë së Prizrenit i kemi mbështetur gjithashtu në realizimin e kampit veror 5 ditor me pjesëmarrje të 200 fëmijëve. Gjatë 2014-ës kemi ofruar mbështetje teknike dhe financiare për realizimin e kampeve verore edhe në famullitë tjera, duke përfshirë edhe famullinë e Klinës ku u bashkuan 20 vullnetarë për të realizuar kampin veror 10 ditor me pjesëmarrje të 220 fëmijëve. Nga kjo mbështetje ka përfituar edhe famullia e Zllakuqanit, ku 25 vullnetarë realizuan kampin veror 10 ditor dhe në aktivitete u përfshinë mbi 180 fëmijë të kësaj famullie dhe fshatrave përreth. Përveç aktiviteteve të lartcekura, programi nacional i animacioneve ka nxitur vullnetarët për të realizuar edhe aktivitete tjera nga të cilat kanë përfituar posaçërisht familjet e varfëra, të cilat janë mbështetur me ndihma humanitare të siguruar nga Caritas Kosova dhe organizata tjera. Në përmbyllje të vitit, tradicionalisht Caritasi po ashtu shënoi Ditën Ndërkombëtare të Vullnetarëve, ku kemi mbledhur të rinjë nga i gjithë territori i Kosovës, duke u ofruar atyre mundësi të veprimtimit të përbashkët, një platformë për shkëmbimin e ideve dhe bashkëpunimin tematik në mes vullnetarëve. Konkretisht në Mitrovicë, Caritas Kosova dhe vullnetarët e saj, në partneritet me Zyrën e Down Sindrom, shkollën speciale Kosovski Bozhur, dhe shkollën fillore Vlado Cetkovic, organizuan aktivitete të rregullta me vullnetarë, si dhe shënuan ngjarje të veçanta si Ditën Ndërkombëtare të Vullnetarizmit, në vazhdim të angazhimeve tona për të promovuar vullnetarizmin. Kjo ditë e veçantë me moton "Nuk jeni të harruar", ishte dedikuar përkrahjes së grupeve sociale të marginalizuara, si për shembull: njerëz të braktisura, të moshuar dhe të sëmurë, fëmijë me sindromin "down," dhe fëmijë nga shkollat speciale dhe shkolla fillore e Veriut. Pako me artikujt ushqimor dhe higjienik u janë shpërndarë për njerëzit në nevojë. Një prej përfituesve, i ulur në karrocën e tij invalidore, me lot në sy pëshpëriti: *"Vizita juaj dhe pakoja është më e vlefshme se mijëra euro."* Përveç kësaj, rreth tetëdhjetë (80) të rinjëve dhe fëmijëve të organizatës Down Sindrom, shkollës speciale dhe fillore u janë dhuruar materiale për punë kreative dhe si rezultat i kësaj ata kanë dizajnuar dhe prodhuar dekorime, kapele, si dhe kartolina për Viti të Ri dhe Krishtlindje. Për fund në nivel dioqezan kemi organizuar ngjarjen e "10 Milion Yjeve" me moton e cila ka përmbajtur mesazhe të paqes dhe ka nxitur dialogun ndëretnik.

KOMPONENTI 4: BASHKËPUNIMI NDERKUFITARE

Në bashkëpunim me Caritas Serbinë dhe mbështetur financiarisht nga CRS, projekti "Ne nuk duam drogë në oborret tona", është zbatuar në Mitrovicë. Projekti ka për qëllim mbështetjen e procesit të pajtimit në mes të komuniteteve të ndryshme etnike dhe fetare që jetojnë në veri të Kosovës, si dhe ti kontribuojë bashkë-ekzistencës së tyre paqësore, duke promovuar tolerancën dhe respektin e ndërsjellë. Në sajë të punëtorive mbi varësinë e drogës në të cilin u mblodhën më shumë se dyqind e pesëdhjetë (250) të rinjë me përkatësi të ndryshme etnike, aktivitetet e projektit kanë siguruar ndërveprim ndërmjet të rinjve, promovimin e zhvillimit të tyre kulturor dhe social. Punëtoritë janë realizuar në katër (4) shkolla fillore dhe katër (4) të mesme në pjesën veriore dhe pjesën jugore të Mitrovicës, duke përfshirë dhe autoritetet vendore përkatëse. Për fund, një grup kompakt i 13 nxënësve nga komunitetet e ndryshme nga pjesa veriore dhe jugore e qytetit janë përzgjedhur për të hartuar opinionin vizual të fushatës mediale, e cila është përbërë nga 250 fletëpalosje, 1600 postera, reklama dhe spote televizive. Në këtë mënyrë të rinjtë janë identifikuar me fushatën dhe kjo gjë ndikoi në komunitet. Reklamat janë paraqitur përmes reklamave gjatë një periudhë prej 2 muajsh, në të dy pjesët e qytetit të Mitrovicës. Për të vlerësuar efektin e kampanjës mediale janë kryer sondazhe para fushatës dhe pas përfundimit të fushatës, me rezultatin që 245 respondentët kanë konfirmuar ndryshimet pozitive nga ndikimi i projektit në popullsinë e synuar.

Për një jetë më të mirë!

KOMPONENTI I: GJILANI, PRISHTINA, MITROVICA, PEJA

Me qëllim të fuqizimit të promovimit të drejtave të njeriut, gjithpërfshirjes sociale dhe përfaqësimit, Caritas Kosova mbetet e angazhuar në avancimin e pozitës së personave me nevoja të veçanta duke zbatuar programe të ndryshme nacionale dhe aktivitete lokale në komunat e Gjilanit, Prishtinës, Mitrovicës, Pejës dhe Prizrenit. Që nga viti 2014, Caritas Kosovo në partneritet me Qendren Kosovare për Vetë-Përkrahje dhe Handikos-in është duke implementuar projektin: “*Personat me aftësi të kufizuara së bashku për një jetë më të mirë*” (POËER)” i cili financohet nga Zyra e Komisionit Evropian në Kosovë dhe Caritas Italiana. Synojmë të fuqizojmë Organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuara (OPAK) duke mundësuar mobilizimin e tyre me qëllim që t’u përgjigjen nevojave të anëtarëve të tyre, duke ndërtuar një model të ri të partneritetit social dhe duke u angazhuar në avokim për politikë-bërjen dhe implementimin e tyre në nivel lokal dhe nacional. Me qëllim të avancimit të pozitës së PAK në shoqëri kemi ofruar trajnime mbi metodologjinë e vetë-përkrahjes, ku pesëmbëdhjetë (15) Grupe Vetë-Përkrahese (GVP) janë themeluar në pesë rajone të Kosovës. Metodologjia e vetë-përkrahjes ka mundësuar një pjesëmarrje më të madhe të anëtarëve në aktivitetet dhe qeverisjen e organizatave të tyre, gjithashtu ka siguruar një nivel më të lartë të ndërmarrësisë përmes ofrimit të ideve për mikro-projekte, si mekanizëm për gjenerimin e të ardhurave. Gjithashtu, janë organizuar edhe trajnime mbi Klasifikimin Ndërkombëtar të Funksionalitetit (KNF) dhe punëtori mbi ndërtimin e kapaciteteve, të cilat rezultuan me shtimin e kapaciteteve të përfaqësuesve të organizatave lokale. Për më tepër, me synim të inkurajimit të komunave për të hartuar planet lokale mbi aftësinë e kufizuar, monitorimit dhe vlerësimit të planit nacional dhe planeve lokale të veprimit mbi aftësinë e kufizuar dhe përmirësimit të koordinimit me OPAK lokale, janë krijuar (3) Grupe Ndër-Sektoriale (GNS) në Lipjan, Novo-Bërdë dhe Vushtrri, ndërsa në komunën e Gjakovës aktiviteti ynë është inkorporuar në Komisionin ekzistues për Personat me Aftësi të Kufizuara. Këto GNS do të krijohen edhe në Pejë, Istog, Mitrovicë, Podujevë, Glogoc, Malishevë dhe Skënderaj. Ndër tjerash, tryeza të rrumbullakëta, aktivitete vetëdijësuese dhe kampanja, siç janë takimet me komunitetin, ligjërata mbi të drejtat e PAK, aktivitete avokuese për zbatimin e ligjeve janë implementuar gjatë vitit 2014. Për fund, projekti i Caritas-it ka kontribuar në mënyrë domethënëse në rritjen e kualitetit të jetës së PAK.

KOMPONENTI 2: PRIZREN

"Ndihma e Hershme është ndihma më e mire," është motoja e angazhimeve tona për fëmijët me nevoja të veçanta (mosha 0-6 vjeç), e që mbetet prioritet i punës tonë në rajonin e Prizrenit. Që nga viti 2008 Caritas Kosova ka implementuar projektin "Detektimi dhe Edukimi i Hershëm," i cili financohet nga Caritasi Gjerman dhe Caritasi dioqezan i Insbruk-ut. Fokusi kryesor i shërbimeve të qendrës qëndron në përkujdesjen dhe asistencën në drejtim të zhvillimit mendor, fizik, shoqëror dhe emocional të 44 fëmijëve Prizrenas, duke ju ofruar atyre mundësi më të mira për përfshirjen sociale për brenda komunitetit ku jetojnë. Po ashtu ndihmojmë prindërit e tyre në ndërtimin e bashkëpunimit me institucionet arsimore dhe shëndetësore për ngritjen e nivelit të integritetit të fëmijëve. Vlerësojmë që intervenimi i hershëm është baza themelore për mësimin e suksesshëm gjatë gjithë jetës së fëmijëve me nevoja të veçanta, që ndikon drejtpërsëdrejti në integrim social, zhvillimin personal dhe punësimin e tyre të mëvonshëm. CK vazhdon të angazhohet në përmirësimin e kushteve për edukim të hershëm të fëmijëve dhe përfshinë të gjithë fëmijët e grupeve etnike, me ç'rast qendra jonë ka epitetin e një qendre multi-etnike dhe multi-fetare.

Ne jemi pjesë e shoqërisë Kosovare!

KOMPONENTI I: FERIZAJ

Që nga viti 2009, Caritas Kosova ka realizuar aktivitete edukative, kulturore dhe sociale, duke përfshirë shërbime shëndetësore në favor të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian (RAE) në fshatin Dubravë, me mbështetjen financiare të Komunës së Ferizajt si dhe përkrahjes së Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT). Nëpërmjet Qendrës sonë socio-edukative, kemi për qëllim përmirësimin e mirëqenies socio-edukative, kemi për qëllim përmirësimin e mirëqenies socio-ekonomike të komunitetit duke lehtësuar qasjen dhe rritjen e pjesëmarrjes së tyre në institucionet e arsimit dhe shëndetësisë. Komuniteti Ashkali përfiton direkt nga aktivitete të ndryshme arsimore që i plotësojnë modulet e tyre shkollore. Çdo ditë rreth pesëdhjetë (50) fëmijë të moshës 3 deri në 6 vjeç ndjekin klasat parashkollë si përgatitje për fillimin e shkollës. Përtej punës me fëmijët, ne kemi arritur të rrisim ndërgjegjësimin e prindërve që arsimi është shumë i rëndësishëm për të ardhmen e fëmijëve të tyre. Në këtë kontekst, ekziston ekipi për parandalimin e braktisjes së shkollës që i motivon nxënësit të regjistrohen në shkollë dhe të ndjekin mësimet rregullisht. Përveç fëmijëve, më shumë se dyqind e pesëdhjetë (250) nxënës të Dubravës, që ndjekin mësimin në shkollën fillore 'Naim Frashëri' në Zaskok, marrin pjesë rregullisht në modulet mësimore plotësuese dhe në programin asistencë në detyrat e shtëpisë. Ndërsa sot rreth 80 fëmijë, respektivisht 50 familje ose 310 banorë, kanë emigruar jashtë Kosovës, duke ndikuar kështu në rënie të numrit të nxënësve në qendër. Ndër tjerash, nxënësit në mënyrë aktive kontribuojnë në aktivitete të lira përmes të cilave ata zgjerojnë njohuritë dhe rrisin nivelin e tyre të socializimit. Ne po ashtu ofrojmë kurse në gjuhën angleze, matematikë dhe informatikë. Përveç kësaj, ne përgatisim nxënësit për testin e arritshmërisë. Në bashkëpunim të ngushtë me personelin e shkollës kemi monitoruar nivelin e zhvillimit të nxënësve, të performancës së tyre, sjelljen dhe higjienën, të cilat janë ngritur gradualisht dhe ndërlidhen drejtpërsëdrejti me pjesëmarrjen e tyre në Qendrën e Caritasit. Caritas Kosova gjithashtu ofron edhe shërbime të shëndetit primar dhe dentare për pacientë; kështu që në vitin 2014 kemi trajtuar 4967 raste mjekësore. Ndërsa në kuadër të komponentit kulturor kemi krijuar grupin e vallëzimit, i cili rregullisht performon në qendër. Për shkak të pjesëmarrjes së shkëlqyer të komunitetit dhe bashkëpunimit të ngushtë me të gjithë akterët, sot qendra jonë është bërë një shembull i suksesshëm i përfshirjes sociale të komunitetit RAE në Kosovë.

KOMPONENTI 2: PRIZREN

Me qëllim të përmirësimit të jetës së komuniteteve minoritare Rom Ashkali dhe Egjiptian (RAE) në Prizren dhe krijimit të kushteve për pjesëmarrje të tyre në procese vendimmarrëse, Caritas Kosova (CK) ka implementuar gjatë vitit 2014 projektin ku në qendër të vëmendjes ishin të rinjtë, të cilëve ju mundësuan trajnime sipas nevojave të tyre e që janë adresuar tek autoritetet lokale, konform planit komunal lokal të veprimit. Po ashtu ky projekt ka mundësuar mobilizimin e të rinjve, sidomos të vajzave dhe grave, në ndërtimin e aftësive për lobim, avokim, rrjetëzim, bashkëpunim dhe lidhshmëri. Gjithsej janë organizuar dymbëdhjetë (12) module trajnime për fuqizim e të rinjve RAE, një mori tryezash të rrumbullakëta, si dhe mbi dyzet (40) seminare. Nder tjerash janë ngritur dhe zhvilluar kapacitetet e tyre për monitorimin, vlerësimin dhe hartimin e dokumenteve zyrtare; pjesëmarrje në jetën politike dhe në procese të vendimmarrjes; gjithnjë duke u bazuar në mundësitë e barabarta për të rinjtë dhe gratë e komuniteteve RAE. Në këtë kontekst, po ashtu është rritur vëmendja dhe hapësira mediale e medieve lokale ndaj komuniteteve pakice. Me ç'rast, është shënuar edhe një intensifikim i angazhimeve të institucioneve vendore për të mbështetur implementimin e planit komunal lokal të veprimit, si dhe alokimin e buxhetit për integrim të komuniteteve pakicë, përkatësisht RAE. Falë veprimtarisë së gjërë të Caritas Kosova dhe akterëve të tjerë mund të konkludojmë se komunitetet pakicë RAE në vitin 2014 janë më të integruar se në vitet paraprake.

KOMPONENTI 3: MITROVICA

Në kuadër të Programit Kombëtar të Pages dhe Pajtimet me fokus në Mitrovicë, Caritas Kosova, mbështetur nga UNICEF, këtë vit ka zbatuar vazhdimin e projektit: "Mbështetje për përfshirjen e fëmijëve RAE (mosha 3-10) nga Mahalla e Romëve në shkollë të rregullt", , me synim për të përmirësuar qasjen në mundësitë për mbështetjen e zhvillimit të fëmijëve RAE përmes përdorimit të programit "Portage". Përveç kësaj, kemi ofruar asistencë shtesë në komunitet për të përmirësuar aksesin e familjeve ndaj institucioneve publike (shërbimet shëndetësore dhe sociale, institucionet komunale dhe arsimore). Për më tepër, Caritas Kosova synon përmes angazhimit të saj të fokusuar në Mitrovicë që të stimulojë edukimin intensiv për komunitetin RAE si vazhdimësi e aktiviteteve tona në zhdukjen e analfabetizmit. Projekti vazhdon të jetë i përkrahur nga Këshilli Danez për Refugjatë, në partneritet me Departamentin Komunal të arsimit, dhe është në përputhje me ligjin për arsim (04 / L-143) dhe trajnim për të rritur në Republikën e Kosovës. Së fundmi, Caritas Kosova është vazhdimisht duke u përpjekur për të mbështetur zhvillimin e komunitetit RAE në perspektivën e edukimit jo-formal dhe rritjen e nivelit të arsimit të komunitetit edhe në Mitrovicë, përkundër fenomenit të emigrimit masiv në vendet e Bashkimit Evropian që është në rritje e sipër.



KOMPONENTI 4: GJAKOVA

Nën ombrellën e Sektorit për Asistencë Sociale dhe Shëndetësore dhe në partneritet me Caritas Zvicrën, Caritas Kosova ka zhvilluar aktivitete sociale në Gjakovë, përkatësisht lagjen "Ali Ibra," me qëllim të promovimit të përfshirjes së komunitetit RAE dhe mbështetjes së integritetit të tyre në shoqërinë kosovare. Konkretisht, strukturat rinore të komunitetit RAE janë përkrahur me aktivitete edukative. Po ashtu janë ndërtuar kapacitetet e grupeve të ndryshme punuese. Ndër tjerash, shumë punëtori dhe takime të rregullta janë mbajtur si dhe aktivitete të përbashkëta me të rinj si mirëmbajtja e ambientit, duke përfshirë aktivitete sportive si turne ose programe animacionesh. Kemi mundur edhe rrjetëzimin e OJQ-vë dhe institucioneve relevante dhe po ashtu kemi iniciuar vizita studimore në aktivitete tona të Caritasit, siç janë "10 milionë yje", dhe "Dita Ndërkombëtare e Vullnetarizmit".

Bukuritë e zonave rurale!

KOMPONENTI 1: PRIZREN

Caritas Kosova, gjatë vitit 2014, ka vazhduar me implementimin e projektit *"Zhvillimi i Qëndrueshëm i agro-biznesit dhe turizmit rural,"* i cili është financuar nga zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe është implementuar në partneritet me Caritasin Ndërkombëtar të Belgjikës. Qëllimi i këtij projekti është zhvillimi i agro - sektorit, bizneseve të vogla dhe të mesme, si dhe zhvillimi i turizmit rural në Kosovën e Jugut. Kjo është arritur duke mbështetur zhvillimin dhe forcimin e iniciativave të fermerëve të rajonit dhe duke nxitur zhvillimin ekonomik. Në mënyrë të veçantë në vitin e parë të projektit kemi qenë të fokusuar në mbështetjen e 500 fermerëve, në tre sektorë kryesorë të agrikulturës si: fruta dhe perime, sektori i bletarisë, dhe i përpunimit të qumështit dhe produkteve të tij, duke mbështetur bizneset e mesme dhe të vogla familjare të fermerëve përfituesë nga rajoni jugor i Kosovës, përkatësisht: Prizren, Mamushë, Rahovec, Malishevë, Suharekë dhe Dragash. Faza e parë e implementimit të këtij projekti, ka përfshirë vizita studimore në Kosovë dhe më gjerë, në rajonin e Ballkanit dhe të Evropës, me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të fermerëve në punë cilësore, duke përfshirë edhe metoda të reja të kultivimit dhe përpunimit. Ndërsa gjatë vitit 2014 projekti një fokusim më të madh kishte në promovimin dhe zhvillimin e turizmit rural dhe bukuritë magjepsëse të cilat ofron vetëm jugu i Kosovës. Pra, qëllimi ynë ishte që hapësirat e bukura, të zgjerohen dhe të rritet përkushtimi ndaj mirëmbajtës se tyre, për të siguruar kështu një zhvillim sa më të qëndrueshëm të bujqësisë, në përgjithësi, dhe bukurive natyrore në zonat rurale.




KOMPONENTI 2: LEPOSAVIÇ

Në bazë të analizave në terren, Zyra Rajonale e Caritas Kosova në Leposaviq gjatë 2014 zbatoi projektin *"Përforcimi i përfshirjes socio-ekonomike të komuniteteve në Komunën e Leposaviqit dhe Mitrovicës Jugore përmes profesionalizimit të sektorit të bujqësisë dhe turizmit rural,"* me qëllim për t'u përgjigjur nevojave të fermerëve lokalë dhe për të mbështetur multi-etnicitetin e shoqërisë në Kosovë, duke krijuar kushte më të mira të jetesës për komunitetet në zona rurale. Projekti u financua nga Ambasada Britanike në Prishtinë dhe është bashkë-financuar nga Caritasi i Belgjikës. Për kundër ndryshimeve politike si pasojë e zgjedhjeve nacionale, strukturat multi-etnike të projektit (ekipi implementues dhe komiteti i menaxhimit) kanë bashkëpunuar me sukses dhe kanë zbatuar në mënyrë efikase projektin. Konkretisht, një numër i konsiderueshëm i ndërmarrjeve familjare dhe shoqatave të fermerëve kanë përfituar nga 40 grantet për agro-biznese, ku kemi përkrahur katër sektorët bujqësor, të tilla si: bletaria, sektori i frutave dhe perimeve, i mishit dhe qumështit; si dhe sektori i eko-turizmit dhe turizmit rural. Më shumë se 300 ndërmarrjeve familjare u janë ngritur kapacitetet profesionale përmes pjesëmarrjes në katër trajnime teknike dhe profesionale, katër vizitave studimore multi-etnike në rajon, si edhe përmirësimin e bashkëpunimit me tregun duke organizuar katër manifestime bujqësore. Përveç kësaj, 75 mikro-kredi bujqësore pa interes u janë shpërndarë fermerëve lokal të Leposaviqit për të rinovuar pajisjet e tyre bujqësore dhe për të rritur të ardhurat e tyre vjetore. Një vëmendje e veçantë i është kushtuar aspektit gjinor, ku nga 300 përfituesë 25% prej tyre ishin gra ndërmarrëse. Për fund, rreth 11% e përfituesve tanë ishin të rinj të papunë që u nxitën qëllimisht për të punuar në sektorin e agrikulturës.

KOMPONENTI 3: MITROVICA

Fuqizimi ekonomik siguron paqen dhe pajtimi ndëretnik në mënyrë shumë efektive. Në kuadër të projektit tonë të Paqes dhe Pajtimit në partneritet me Caritasin Francez, janë përkrahur në fushën e agrikulturës përfitues nga radhët e komuniteteve të ndryshme që jetojnë në Mitrovicë. Projekti *"Forcimi i përfshirjes Socio-Ekonomik të komuniteteve në Komunën e Leposaviqit dhe Mitrovicës së Jugut përmes profesionalizimit të bujqësisë dhe sektori të turizmit rural"* është mbështetur në vazhdimësi nga Ambasada Britanike dhe Caritasi Belg, ku kemi ofruar trajnime për bletari dhe turizëm rural duke siguruar kështu rritjen e njohurive dhe ekspertizën e fermerëve. Për herë të dytë, Caritas Kosova ka ndihmuar në organizimin e ngjarjeve lokale bujqësore, si: "Dita e Bletarisë së Luginës së Ibrit 2014" në Komunën e Leposaviqit, dhe "Panairin Bujqësor Rajonal - Mitrovica 2014". Arritja e kësaj ngjarje ishin takimet e para dhe të përsëritura në mes fermerëve shqiptarë dhe atyre serb. Ky grup etnikisht i përzier i përfituesve mori pjesë edhe në jubileun e 40. të Panairit Ndërkombëtar të bletarisë "Tasmajdan 2014", duke mbledhur kështu më shumë se dyzet (40) fermerë kosovarë nga rajoni i Mitrovicës dhe Leposaviqit. Panairi kontribuoi dukshëm në bashkëpunimin ndër-etnik dhe rajonal, me që disa prej fermerë shqiptarë vizitonin Serbinë për herë të parë në kohen e pasluftës. Pa dyshim zbatimi i projektit ka nxitur shumë takime ndër-biznesore dhe miqësore në mes fermerëve të Mitrovicës dhe të Leposaviqit, duke mundësuar kështu rrjetëzimin, shkëmbimin e njohurive dhe ekspertizës, si dhe ngritjen e nivelit të socializimit ndëretnik.



Ato meritojnë një shans të dytë!

Duke filluar nga vitit 2013, Caritas Kosova ka vazhduar zbatimin e projektit e "re-integrimit të burgosurve pas lirimit, projekt ky i cili trajton një nga grupet më të marginalizuara në shoqërinë kosovare, në partneritet kryesor me Secours Catholique - Caritas Franca. Në kohëzgjatje prej tri vitesh grave dhe të miturve të burgosur në Qendrën Korrektuese në Lipjan me anë të këtij programi iu mundësohet re-integrimin në shoqëri pas lirimit të tyre. Caritasi në kuadër të këtij projekti ofron trajnime profesionale dhe ngritjen e vetëdijes shoqërore për rëndësinë e ri-integrimit të burgosurve. Përfituesve të projektit, përkatësisht femrave të burgosura, ju ofrohen trajnime profesionale të certifikuara në floktari dhe rrobaqepësi, ndërsa rreth dyzet e shtatë (47) të mitur përfitojnë nga aktivitetet kulturore dhe sportive.

Caritas Kosova ka një bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Drejtësisë (MD) dhe Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS). Nënshkrimi i Memorandumeve me Ministrinë përkatëse mundëson koordinimin e veprimeve në zbatimin e projektit si dhe kontribuon në organizimin e trajnimeve të certifikuara profesionalisht për të burgosurat të cilat pas përfundimit të suksesshëm të trajnimit pajisen nga Qendrave për Trajnime Profesionale me certifikatë të njohur zyrtarisht në fushën e floktarisë dhe rrobaqepësisë.

Gjatë vitit 2014, janë trajnuar dhe certifikuar gjithsej dhjetë (10) gra të burgosura, pesë (5) në floktari dhe pesë (5) në rrobaqepësi, të cilat pas përfundimit të trajnimit kanë kaluar me sukses testin teorik dhe praktik sipas modulit të Qendrave të Aftësisimit profesional. Përfundimi i trajnimit me sukses dhe ceremonia e shpërndarjes së certifikatave ka emocionuar të burgosurat, ku shumë prej tyre kanë shprehur gatishmërinë e tyre që ta ushtrojnë këto profesione pas ri-kthimit në jetë. Përveç vazhdimit të trajnimeve, tashmë janë përzgjedhur dy (2) përfituese si asistente të trajnerëve e që gradualisht do të aftësohen si trajnere dhe në të ardhmen ato do të trajnon të burgosurat tjera. Mbi të gjitha, faktor i rëndësishëm është se të burgosurat kanë shprehur interes dhe gatishmëri të madhe për të marrë pjesë në këto trajnime, pasi që vlerësojnë se këto trajnime janë një shans i mirë për të lehtësuar re-integrimit të tyre pas lirimit.

Ta ndryshojmë botën!

Caritas Kosova, vazhdon të jetë i përkushtuar në implementimin e projekteve që sigurojnë dhe rrisin cilësinë në fushën e edukimit. Edhe përgjatë vitit 2014, në bashkëpunim me Komunën e Ferizajt, ka vazhduar punën çerdhja e re që është hapur në vitin 2013, e cila ka një numër prej mbi 250 fëmijëve me grup-moshat nga 6 muaj deri në moshën 6 vjeçare. 50 anëtarë të personelit dhe hapësira prej 1.172 m² e bënë të jetë ndër çerdhet më të mëdha në Kosovë, jo vetëm për nga hapësira, por edhe numri i fëmijëve dhe stafit të angazhuar. Përpos kapaciteteve infrastrukturore, kjo çerdhe ofron edhe shërbime mjaft cilësorë në edukim, duke përmbushur të gjitha standardet e përcaktuara nga politikat arsimore që rregullojnë sferën e arsimit parafillorë. Pikërisht viti 2014 i është dedikuar avancimit dhe rritjes së mëtutjeshme të cilësisë së shërbimeve e që krijojnë një ambient sa më të ngrohtë për fëmijët. Përveç rritjes së cilësisë në shërbime dhe programeve tjera që ndikojnë drejtpërsëdrejti në zhvillimin psikik të fëmijëve, ne po ashtu jemi angazhuar për një edukim edhe në të ushqyerit që ndikon në zhvillimin fizik të fëmijëve tanë. Pra, kemi gërshtuar anën intelektuale dhe emocionale me një kujdes tejet të veçantë edhe tek aspekti shëndetësorë i fëmijëve. Çerdhja e re në Ferizaj, një ndër investimet me të mëdha në edukimin parashkollor në vend, karakterizohet edhe nga diversiteti i fëmijëve. Trajtimi i barabartë dhe jo-diskriminues i fëmijëve është një kriter i rëndësishëm në punë dhe misionin e Caritasit. Aktualisht, pjesë aktive janë edhe fëmijët nga komunitetet: Romë, Ashkali dhe Egjiptian. Në këtë kontekst, duhet theksuar që edhe fëmijët me aftësi të kufizuara janë pjesë e barabartë e grup-moshave të ndryshme në çerdhe dhe që të gjithë fëmijët trajtohen më profesionalizëm. Në raste më nevojë veçanta bashkëpunojmë ngushtë me institucionet relevante, organizata e ekspert profesional, në mënyrë që t'u përgjigjemi të gjitha specifikave duke arritë kështu ngritjen e socializmit në mes fëmijëve. Ky përkushtim ndaj fëmijëve, do të vazhdojë edhe në të ardhmen, meqë dëshirojmë një ardhme të ndritur dhe një botë më të mirë për fëmijët tanë.



Në shërbim të t'varfërve!

Përkundër investimeve të mëdha pas lufte dhe zhvillimit gradual, Kosova vazhdon të përballet me statistika shqetësuese të varfërisë dhe të papunësisë. Sot ne ende jemi shteti më i varfër në Evropë. Papunësia është e pranishme sidomos tek femrat, të rinjtë dhe komunitetet minoritare. Ndërsa varfëria po thellohet gjithnjë e më shumë në zonat rurale. Prandaj, Caritas Kosova (CK) përmes programit të asistencës sociale vazhdon të përkrahë individ dhe familje që jetojnë në varfëri ekstreme. Në vitin 2014 në mënyrë të drejtpërdrejt kemi përkrahur mbi 1129 persona nga Ferizaj. Po ashtu, përmes strukturave tona decentrale kemi përkrahur të varfërit në Prishtinë, Mitrovicë, Gjakovë dhe Klinë dhe Prizren.

Ndërsa në mënyrë jo të drejtpërdrejt, kemi përkrahur persona në nevojë dhe grupet e marginalizuara përmes institucioneve qeveritare dhe lokale si: Qendra për Punë Sociale, Qendra për Integrim dhe Rehabilitim të të Sëmurëve Kronik dhe Psikiatrik në Shtime. Ndër tjerash, Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) në Ferizaj është mbështetur me shtretër dhe inventar për spital. Gjatë këtij viti, mbështetja nuk i ka munguar as Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Rahovec. Shkollat Filllore e Mesme e Ulët në Surqinë, Bec dhe Ferizaj janë mbështetur me inventar shkollor. Gjithashtu, sporti i Ferizajt është mbështetur nga ne.

Edhe në vitin 2014 kemi bashkëpunuar me organizatat dhe shoqata të tjera joqeveritare. Falë këtij bashkëpunimi, janë mbështetur pensionistët dhe invalidët e punës në Viti dhe Ferizaj, pastaj Handikos-i në Ferizaj dhe Shtime, si dhe personat me nevoja të veçanta. Ndërsa në Gjakovë janë mbështetur personat me shikim të dobësuar dhe të verbër. Një kujdes të veçantë i kemi kushtuar përkrahjes së grave dhe fëmijëve - viktimat të dhunës në familje. Në vazhdimësi, Qendra Edukative "Don Bosco" në Prishtinë është përkrahur. Po ashtu, falë bashkëpunimit me famullitë dhe kongregatat janë mbështetur kopshtet e fëmijëve pranë famullive dhe menzat për të varfër.

I tërë ky kontribut i lartcekur u bë i mundur vetëm falë zemërgjerësisë së vëllezërve tanë në Gjermani. Konkretisht organizata humanitare dhe vullnetare "Junge Leute Helfen" (shq. Të rinjtë ndihmojnë) që nga koha e pasluftës nuk ka kursyer mundin e saj që t'ju vije në ndihmë familjeve dhe individëve që jetojnë në varfëri ekstreme. Përveç punës së tyre vullnetare që bëjnë me shumë përkushtim, ata çdo vit vizitojnë Kosovën dhe me ç'rast të gjithë ato familje që ndihmohen në vazhdimësi. Gjatë vitit 2014 janë zhvilluar dy vizita. Vullnetarët gjerman, të shoqëruar nga stafi i Caritas Kosova vizituan qendrat e Caritasit dhe partnerëve tanë; ndër tjerash, edhe QKMF-në në Ferizaj, Spitalin Rajonal, Qendrën e re të Emergjencës në Ferizaj, Qendrën Sociale dhe Edukative në fshatin Dubravë të Ferizajt, Komunën e Ferizajt, si dhe familjet skamnore përfituese të asistencës sociale në Ferizaj. Pastaj, vizituam Komunën e Therandës dhe qendrën e Caritasit "Perkujdesit shtëpiak", si dhe Qendrën e Caritasit për fëmijë me nevoja të veçanta në Prizren. Ndërsa, në kuadër të vizitës së dytë të realizuar në Gusht të vitit 2014, vullnetarët gjerman vizituan familjet përfituese të asistencës sociale në Klinë dhe Komunën e Klinës, ku morën pjesë në kampin veror të Caritas Kosovës dhe ndihmuan të moshuarit e braktisur në mirëmbajtjen e shtëpive të tyre. Për fund, të rinjtë u zotuan që do ta përkrahin Caritasin dhe Komunën e Ferizajt për hapjen e një menze për personat e varfër në Ferizaj, ashtu që t'ju sigurojmë dhe shërbejmë të varfërve nga një shujtë të ngrohtë ushqimi.



Caritas Kosova (CK), që nga viti 2008, është anëtarë i Grupit të Emergjencave të Caritas-eve të Evropës jug-lindore dhe implementon në mënyrë profesionale metodologjinë "Reduktimi i Rrezikut nga Fatkeqësitë (Disaster Risk Reduction - DRR) dhe standardet ndërkombëtare të përcaktuara nga SPHERE apo Karta Humanitare dhe Standardet Minimale në Intervencime Humanitare). Gjatë vitit 2014, Caritas Kosova ka vazhduar angazhimet në kuadër të grupit të emergjencave duke marrë pjesë në trajnime e takime të organizuar nga Caritasi i Bullgarisë. Ku po ashtu kemi finalizuar hartimin e Planit Nacional Emergjent për Republikën e Kosovës.

Sipas Planit Strategjik 2013-2017 të CK-së, sektori dhe programi i emergjencave vazhdon të jetë i "deaktivizuar" (stand-by), por në gjendje gatishmërie për intervenim emergjent. Gjate këtij viti kemi vazhduar më krijimin dhe ngritjen e kapaciteteve të grupeve lokale të emergjencave, të cilat janë aktive në regionet e respektive dhe përbrenda zyrave ekzistuese të Caritasit.

Fatmirësisht gjatë vitit 2014 nuk kemi realizuar ndonjë intervenim në regionin e Kosovës, meqë nuk ka ndodhur ndonjë fatkeqësi natyrale ku do të kërkohej asistimi ynë. Megjithatë, Caritas Kosova në bashkëpunim me Caritasin e Serbisë dhe partneret e tjerë si Junge Leute Helfen, ka ofruar mbështetje emergjente për të prekurit nga vërshimet në Serbi, konkretisht në qytetin e Paracinit, duke dërguar një kontingjent më ndihma humanitare.

Caritasi në aksion!






Raporti Financiar 2014


PËRQINDJET SIPAS PROGRAMEVE

BUXHETI VJETOR 2,278,572.80€



- 36% Programi Përkujdesi Shtëpiak
- 3% Programi Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore
- 6% Programi Nacional i Paqës dhe Pajtimimit
- 8% Programi për Integrimin e RAE
- 10% Programi Edukativ
- 8% Programi Nacional për Njerëz me Nevoja të Veçanta
- 2% Re-Integrimi i të Burgosurve pas Lirimit
- 1% Programi i Asistencës Sociale
- 22% Programi i Agrikulturës
- 4% Struktura e Caritas Kosova

PËRQINDJET SIPAS DONATORËVE



- 26% Caritas Network
- 51% Komunat
- 12% Bashkimi Evropian
- 10% Ministritë
- 1% Tjera

VLERË MONETARE

VLERË MATERIALE

46,200.00 €

225,000 TON

Shënim: NDIHMA HUMANITARE

Caritas Kosova

**Rr. Rexhep Bislimi
Kisha Katolike
70 000 Ferizaj,
Kosovë**

tel.+381(0) 290/328 110

fax. +381 290/396 588

info@caritaskosova.org

www.caritaskosova.org

Përgatiti : Caritas Kosova

Dizajnoi: ©Lekë Laçi

**Falenderim i vecantë i shkon Institucioneve
dhe partnerëve të Caritaseve:**

Caritas Internationalis

Caritas Europa

Deutscher Caritas Verband

Secours Catholique

Caritas Italiana / Caritas Umbria Toscana

Caritas Swiss

Caritas International Belgium

Caritas Rumania / Caritas Slovenia

Caritas Czech Republic

Caritas Innsbruck

Maatwerk Terugkeer

CRS

FES

PTK

Prishtina International Airport "Adem Jashari"

Komunat: Suharekë, Ferizaj, Viti, Rahovec, Gjilan

Klina, Malisheva, Drenas, Shtime

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

Ministria për Rini, Sport dhe Kulturë

Ministria e Drejtësisë

Kuvendi i Kosovës


Ambasada Britanike

Caritas Development Funds

European Union in Kosovo

DRC / UNDP / UNICEF / KFOR

Junge Leute Helfen



SOROS
Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo
Kosovo Foundation for Open Society

DANISH REFUGEE COUNCIL

Shënim:



CARITAS KOSOVA

Amour
Liebe *Ljubav*
Amore
Alhwa *Love*
Caritas
Sneh *Kamipe*
Sevgi *Labibi*
Agape *Dashuri*